



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 2, Datë 16.02.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR RRUGËN “BANJË-GRAMSH DHE URA E TRASHOVICËS”, ME VENDNDODHJE KOMUNA TREGAN, GOSTIMË, PISHAJ, QARKU ELBASAN, NË KUADËR TË PROJEKTIT HIDROENERGJETIK TË DEVOLLIT

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, VKM-së nr. 877, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për rrugën “Banjë – Gramsh dhe Ura e Trashovicës”, me vendndodhje komuna Tregan, Gostimë, Pishaj, Qarku Elbasan, në kuadër të projektit hidroenergjetik të Devollit dhe subjekt kërkues shoqërinë “Devoll Hydropower” Sh.a.
2. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
  - a. Dokumenti i Rregullores së Lejes së Ndërtimit;
  - b. Harta e Planvendosjes së Strukturës.
3. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës për lëshimin e Formularit të Lejes së Ndërtimit.
4. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njërive të Qeverisjes Vendore.
5. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Komuna Tregan, Gostimë dhe Pishaj për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



